




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



**PROCESVERBAL NGA DËGJIMET
BUXHETORE
TAKIMI ME OJQ-TË, BIZNESET,
FERMERËT DHE GRUPET E
INTERESIT**

21.05.2026

Procesvebal nga takimi me oj-q-të, bizneset, fermerët dhe grupet e interesit.

Blertë Gashi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, drejtor për Buxhet dhe Financa, anëtarë të grupit punues dhe ju qytetarë të pranishëm. Ky është cikli i parë i dëgjimeve buxhetore për përgatitjen e kornizës afatmesme buxhetore dhe takimi i katërt me radhë. Ky proces shënon fillimin e konsultimeve publike dhe bashkëpunimit institucional për planifikimin e prioriteteve dhe projekteve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Qëllimi i dëgjimeve është që përmes diskutimeve tuaja të identifikohen prioritetet kryesore për investime dhe shërbime. Çdo propozim dhe çdo kërkesë e juaja do të trajtohet nga grupi punues gjatë hartimit të dokumenteve buxhetore.

Afrim Limani: Të nderuar pjesëmarrës! Më lejoni që në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa t'ju shpjegojë buxhetin komunal për vitin 2027. Më datë 16 maj ka ardhur Qarkorja e Parë Buxhetore, që është dokument i rëndësishëm financiar i përcaktuar me Ligjin e Financave Publike dhe Përgjegjësisive dhe e përcakton hisen buxhetore për çdo komunë të Republikës së Kosovës. Sipas këtij dokumenti, buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2027 është 21.704.000€ dhe ndahet sipas programeve. Në administratë: 9.946.000 dhe kur e bëjmë një krahasim me vitin aktual, kemi rritje të buxhetit prej 778.000€. Në arsim: 634.305 dhe kur bëjmë krahasim me vitin 2026, kemi një zvogëlim prej 660.000. Në shëndetësi: 2.323.000 dhe kur bëjmë krahasim me vitin aktual, kemi një rënie prej 36.000. E falënderoj ekipin tim të financave, që brenda një afati shumë të shkurtër kemi bërë një punë shumë intensive. Në kategori ekonomike, përafërsisht buxheti duhet të jetë kështu: Pozicioni i pagave: 12.919.000€, mallra dhe shërbime 2.821.000, shpenzime komunal 440.00, subvencione 1.000.000 dhe investime kapitale 4.523.000, 374.000 euro më pak në vitin 2027 se sa në vitin 2026. Të nderuar pjesëmarrës, si rezultat i kontratës kolektive jemi në një krizë financiare, kreyt kjo si pasojë e kontratës kolektive, e cila deri më tani i ka tërhequr 3.5 milionë. Buxheti i arsimit gjithashtu ka ndikuar që ulje të buxhetit, sepse mungesa e nxënësve llogaritet sipas formulës. Drejtpërdrejt në zvogëlimin e buxhetit është edhe numri më i vogël i popullsisë, pra jemi 14.000 banorë më pak se sa në regjistrimin e parafundit. Ju ftoj t'i paraqitni pyetjet dhe kërkesat e juaja rreth këtij dëgjimi publik.

Shkumbim Arifi: Ajo që the është shqetësuese, sa i përket numrit të nxënësve! Dua të theksoj se vlera më e madhe e një komuna janë qytetarët e saj. Ky proces duhet të ndalet. Kam informata jozyrtare që shumica e nxënësve po shkojnë në Gjakovë, Prizren etj... E rithekoj idenë që duhet të rritet buxheti në kulturë e rini, 20.000 euro për kulturë janë pak. E di që para disa viteve e kam propozuar teatrin amator, por asnjëherë nuk është buxhetuar. Nuk po them teatër profesionist, por me një buxhet prej 10.000euro në vit.

Vjollca Gurgule: Një kërkesë: Një problem e kemi me të rinjtë e fshatit Xërxë, Gurit të Kuq. Për shkak të mungesës së linjës së busit, ata udhëtojnë në Gjakovë e Prizren për t'u shkolluar. Është matje saktë që është bërë nga SLH Kosova. Rreth 1000 të rinj udhëtojnë për Gjakovë e Prizren dhe kjo dukuri është mirë të ndalet me ndonjë planifikim të mirë.

Hamëz Rama: Nuk kemi shumë hapësirë ta japim një debat në mënyrë të shtjelluar, sepse e shpjeguat shumë mirë buxhetin dhe sektorët e tij. Sektori i verarisë konsiderohet sektor me mjaft potencial. Si shoqatë kërkoj që, të rishikoni kapacitetet e juaja dhe të parashikohet një shumë e caktuar për ne, sepse i kemi paraqitur projektet dhe aktivitetet tona. Kjo është një kërkesë dhe shpresojmë që në buxhetin 2027 shoqata jonë ta ketë një mbështetje financiare nga komuna.

Afrim Limani: Juj falënderoj për pyetjet! Shkumbim, të them të drejtën tani nuk mund të të jap përgjigje, sigurisht me një konsultim me drejtorin e kulturës duhet ta shikojmë se ku ka mbetur puna. Është i nevojshëm teatri dhe ju falënderoj për kontributin. Vjollcë, një kohë të shkurtër kam qenë edhe drejtor i Arsimit. Për bartjen e nxënësve i kemi disa kontrata, por te nxënësit e shkollës së mesme nuk e di. Më la përshtypje pyetja dhe hulumtimi juaj. Hamëz, të falënderoj për pyetjen! Për buxhetin e vitit të ardhshëm do ta trajtojmë më kujdes kërkesën tuaj dhe besoj që do të kemi mundësi ta mbulojmë këtë lloj kërkesë nga shoqata Enologjia. Nëse nuk ka pyetje të tjera, këtë takim e konsideroj të mbyllur. Ju falënderoj të gjithëve.

Procesmbajtës: Albion Krasniqi